



Programi i kandidatit për kryetar të Komunës së Prizrenit z. Hanefi Muharremi

Vizioni i LDK-së për Komunën e Prizrenit:

Prizreni, një komunë e njohur për ekonomi dinamike, me mjedise urbane dhe rurale të zhvilluara që janë burim zhvillimor i Komunës dhe i Kosovës në përgjithësi, me jetë cilësore për të gjithë qytetarët, me arsim dhe shërbime shëndetësore cilësore, me rini prosperuese dhe ambient tërheqës për investime.

Tetor 2009

Përmbajtja e programit

1	Fjala hyrese	faqe ...4
2	Hyrje	faqe ...4
3	Komuna e Prizrenit : Kontesti	faqe ...4
4	Objektivat Programore	faqe ...5
5	pasqyrimi I pergjithshem I sektoreve /fushave	faqe ...6
6	Zhvillimi ekonomik I komunes	faqe ...6
7	Urbanizmi dhe zhvillimi urban I komunes	faqe ...7
8	Sektori I Arsimit	faqe ...12
9	Sektori I Shendetesise	faqe ...16
10	Sektori I Bujqesise	faqe ...18
11	Sektori për Kulture,Rini,Sport dhe Turizem	faqe ...20
12	Sektori i Sherbimeve Publike	faqe ...25
13	Lista e projekteve	faqe ...31
14	Buxheti komunale dhe menaxhimi financiar i komunes	faqe ...33
15	Cilesia dhe efikasiteti I sherbimeve komunale	faqe ...33
16	Qeverisja komunale efektive, transparente	faqe ...34
17	Biografia e kandidatit per kryetar te komunes,H.muhametari	faqe ...35

Fjala hyrëse e z Hanefi Muhharremi

Të dashur qytetar të Komunës së Prizrenit!

Jemi para një fillimi të ri për të bërë Komunën e Prizrenit., vend të krenarisë tonë dhe të gjithë Kosovës.

Unë prezantohem para jush si kandidat për kryetar të Komunës së Prizrenit për të kërkuar mbështetjen e juaj për të shndërruar Komunën tonë në vendin ku do të lulëzojë biznesi dhe punësimi, me një infrastrukturë të zhvilluar rrugore, me shkolla dhe institucione shëndetësore moderne të shtrira në të gjitha lokalitetet e komunës.

Unë prezantohem para jush për të kërkuar votën tuaj për tu siguruar fëmijëve tanë hapësira për zhvillimin e tyre sportiv dhe kulturor. Unë jam këtu për të kërkuar mbështetjen e juaj për të ndërtuar së bashku një qytet me ekonomi të zhvilluar që do të jetë burim i zhvillimit ekonomik të të gjithë Kosovës duke vënë në funksion resurset e begatshme që ka Komuna e Prizrenit

Jam këtu për të realizuar një vizion të ri zhvillimor të Komunës së Prizrenit dhe për të vënë bazat për zhvillim afatgjatë e të qëndrueshëm.

Programi im dhe i LDK-së për qeverisjen e ardhshme lokale bazohet në nevojat e qytetarëve. Programi të cilin ju prezantoj siguron një qeverisje transparente dhe efikase në katër vitet e ardhshme të qeverisjes lokale.

Ky program është rezultat i debateve dhe analizave të shumta që janë zhvilluar në të gjitha lokalitetet e komunës. Ajo që e bënë të veçantë këtë program dhe të realizueshëm njëkohësisht është fakti se vetë qytetarët kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në përpilimin e tij.

Programi është begatuar dukshëm nga diskutimet me grupe të qytetarëve, si me njerëz të arsimit, kulturës e sportit, bujqë, mjekë, pensionistë, femra etj.

Programi arrin të identifikojë përparësitë kyçe zhvillimore të komunës dhe t'i nxjerrë ato në pah për të siguruar zhvillim afatgjatë të komunës së Prizrenit

Programi është i tillë ashtu që siguron një zhvillim të balancuar të zonave urbane dhe rurale të komunës për tu mundësuar të gjithë qytetarëve të përfitojnë nga zhvillimi ekonomik i komunës.

Tani është koha që të vendosim për të ardhmen e komunës tonë. Ta bëjmë atë një vend tërheqës për të jetuar dhe për të rritur fëmijët tanë.

I juaji,
Hanefi Muhharremi

1. Hyrje

Programi për qeverisjen e ardhshme komunale i prezantuar në vijim bazohet në objektivat strategjike të Lidhjes Demokratike të Kosovës të prezantuara në programin e saj.

Ky program është punuar me involvimin e gjerë të shumë ekspertëve dhe të diskutimeve në kuadër të Forumit për Zhvillimin e Komunës së Prizrenit si trupë ku marrin pjesë shumë ekspertë të fushave të ndryshme, biznesmenë, aktivistë, qytetarë të shumtë të të gjitha lokaliteteve, të rinjë, femra, grupe të marginalizuara etj.

Programi reflekton plotësisht nevojat e qytetarëve të komunës së Prizrenit të identifikuar nga shumë takime që janë bërë në të gjitha lokalitetet e komunës. Si i tillë, ky program është real, përmbajtësor dhe bazohet në gjendjen aktuale dhe objektivat zhvillimore të komunës.

Programi gjithashtu parasheh mekanizmat për tu adaptuar ndaj ndryshimeve që mund të ndodhin gjatë katër viteve të qeverisjes komunale.

Ashtu si është përgatitur me involvimin e gjerë të qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit në komunë, ky program do të realizohet përmes një pjesëmarrje aktive të qytetarëve në definimin e prioriteve afatshkurtra dhe më konkretisht realizimit të projekteve zhvillimore në baza vjetore.

Programi parasheh mekanizmat për monitorim të realizimit të tij përmes një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës.

2. Komuna e Prizrenit: Konteksti

Komuna e Prizrenit, e shtrirë në pjesën juglindore të Kosovës dhe me një sipërfaqe prej 640 km² dhe me një popullsi prej ~ 230.000 mijë banorë të shpërndarë në qytetin e Prizrenit dhe në 75 fshatra, konsiderohet të jetë qendër e rëndësishme në Kosovë sidomos në sektorin e bujqësisë. Komuna e Prizrenit është e njohur për produktet e agrokultures, Resurset e favorshme turistike, popullsia e re dhe e përkushtuar për punë dhe biznes dhe pozita gjeografike e favorshme që ka Komuna e Prizrenit janë përparësitë krahasuese shumë të rëndësishme që duhet të shfrytëzohet dhe të vihet në funksion të zhvillimit të ardhshëm.

Ekonomia e Komunës së Prizrenit kryesisht është stabile dhe në veçanti është e zhvilluar vreshtaria, që është e njohur në Kosovë dhe jashtë. Disa bujqë dhe ndërmarrje kanë arritur suksese të jashtë zakonshme në ngritjen e fermave dhe bizneseve dhe në plasimin e produkteve brenda dhe jashtë Kosovës. Megjithatë këto biznese duhet të përkrahen pasi ato janë shumë të rëndësishme për të siguruar vende pune për popullsinë e re dhe të ardhura për familjet.

Infrastruktura e Komunës së Prizrenit ka pësuar ndryshime rrënjësore që nga viti 1999. Vlerësimet janë se ende mbetet shumë për tu bërë për të siguruar një infrastrukturë funksionale dhe të integruar në të gjithë territorin e komunës. Në veçanti, infrastruktura e zonave rurale mbetet ende e pakënaqshme duke e vështirësuar jetën e qytetarëve dhe parandaluar një zhvillim më të hovshëm të zonave rurale.

Komuna e Prizrenit ka një histori të pasur, mbetjet e të cilës duhen të ruhen me fanatizëm për gjeneratat e ardhshme dhe për ta bërë Komunën e Prizrenit një vend atraktiv për tu vizituar si nga kosovarët ashtu edhe nga të huajt. Disa vlerësime dhe gjurmime arkeologjike e nxjerrin në pah kulturën e pasur që nga koha iliro-romake.

3. Objektivat programore

Objektivat programore të qeverisjes së ardhshme katër vjeçare bazohen në vizionin për Komunën e Prizrenit që është: **Prizreni, një komunë e njohur për ekonomi dinamike, me mjedise urbane dhe rurale të zhvilluara që janë burim zhvillimor i Komunës dhe i Kosovës në përgjithësi, me jetë cilësore për të gjithë qytetarët, me arsim dhe shërbime shëndetësore cilësore, me rini prosperuese dhe ambient tërheqës për investime.**

Objektivi 1: Komuna e Prizrenit e njohur në vend dhe jashtë për ekonomi të zhvilluar, posaçërisht ekonominë bujqësore dhe produktet bujqësore, të cilat produkte do ta formojnë markën e tyre në vend dhe jashtë.

Objektivi 2: Komuna e Prizrenit me lokalitete rurale të zhvilluara me infrastrukturë moderne rrugore, kanalizim/mbeturina dhe furnizim me ujë për të siguruar jetë cilësore dhe zhvillim ekonomik dhe vende pune për shumë të rinj.

Objektivi 3: Zhvillim i balancuar dhe funksional hapësinor duke siguruar mbrojtjen e ambientit dhe gjithashtu duke përkrahur zhvillimin ekonomik .

Objektivi 4: Ofrimi i mbështetjes për biznese dhe NVM që gjenerojnë punësim dhe të ardhura për familjet.

Objektivi 5: Zhvillim i kulturës, sportit dhe rinisë dhe popullatën e re dhe prosperuese.

4. Pasqyrim i Përgjithshëm i Sektoreve/Fushave

Në vijim është lista fushave dhe sektorëve në të cilat do të bazohet ekzekutivi në Komunën e Prizrenit gjatë mandatit të ardhshëm katër vjeçar. Këto projekte janë identifikuar nga diskutimet e shumta me qytetarë të gjitha lokaliteteve të komunës dhe me grupe të tjera të interesit.

Projektet dhe përshkrimet në vijim janë të analizuara në bazë të gjëndjes ekzistuese në tërësi dhe planet në afatin katërvjeçar për realizimi dhe përmbushjen e obligimeve të marra në mandatin e paraparë me ligj.

4.1 Zhvillimi ekonomik i komunës

Në fushën ekonomike, prioritet do të jetë krijimi i vendeve të reja të punës. Të gjitha aktivitetet e komunës do të orientohen në këtë drejtim.

Do të ndërmerren veprime konkrete për të përkrahur bizneset, në veçanti ato që gjenerojnë punësim në Komunën e Prizrenit.

Do të përpilohet Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Prizrenit e cila do të definojë kahjen e zhvillimit të Komunës. Kjo strategji do të përpilohet me pjesëmarrje aktive të bizneseve dhe grupeve tjera të interesit.

Do të përkrahen zejet e vjetra që kanë ekzistuar në Komunën e Prizrenit, të cilat përveç se gjenerojnë punësim paraqesin edhe vlerë historike të Komunës.

Duke patur parasysh se Komuna e Prizrenit i ka taksat me të ulëta në krahasim me komunat tjera ose në nivel të shtetit, atëherë kemi lehtësira në përgjithësi për biznesin në komunën tonë duke mundësuar një zhvillim më të hovshëm të bizneseve në përgjithësi e në veçanti të atyre që gjenerojnë punësim.

Nën udhëheqjen e Kryetarit të Komunës, do të formohet grupi këshillëdhënës për zhvillim ekonomik i komunës që do të jetë një gjenerator i masave dhe veprimeve konkrete të komunës për të përkrahur bizneset dhe zhvillimin e komunës në përgjithësi.

Do të punohet me grupe të interesit në gjithë Kosovën për të promovuar Komunën e Prizrenit si vend atraktiv për investime.

Do të definohen zonat ekonomike në kuadër të pronave komunale ku do të kenë mundësi të vendosen bizneset që zgjedhin të investojnë në Komunën e Prizrenit.

Do të funksionalizohet plotësisht 'One-stop-shop' në komunë për t'u mundësuar bizneseve kryerjen e të gjitha shërbimeve komunale në një vend.

Do të punësohen konsulent biznesi për tu ofruar bizneseve të reja konsulentë në fushën e biznesit, financave dhe taksave etj. falas.

Plani strategjik i zhvilluar mirë, të cilin plan LDK do ta mbëhstesë dhe përkrahë, do t'i mundësojë qytetarëve:

- Të qartësojë zhvillimin e ardhshëm;
- Të vendosë mbi fushat prioritare për veprim;
- Të përshtatë ndryshimet sociale dhe mjedisin ekonomik;
- Të drejtojë organizatën komunale drejt arritjes së synimeve dhe objektivat e planit strategjik, ti lidhë këto me përmirësimet kapitale vepruese;
- Të zgjerojë komunikim mes qytetarëve, për t'i siguruar se në vendimet e ardhshme janë përfshirë interesat për çështje ekonomike, sociale dhe mjedisore.

▪ Identifikimi i prioriteteve zhvillimore

Identifikimi i prioriteteve zhvillimore do të ndihmonte në përmirësimin e planit të investimeve kapitale në infrastrukturë. Sipas propozimeve dhe kërkesave të qytetarëve synohen të arrihen këto objektiva zhvillimore:

- Zhvillimi i infrastrukturës lokale (rrjeti i ujësjellësve, kanalizimeve, ndërtimi i rrugëve, etj.);
- Përmirësimi i ambientit për të jetuar sa më mirë;
- Ngritja e mirëqenies sociale për të gjitha komunitetet;
- Përmirësim në sferën e shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe sportit;
- Hartimin e planeve rregullative të qytetit;
- Përkrahje dhe zhvilloj biznesin, si dhe krijimin e parakushteve për investime të jashtme;
- Krijimin e vendeve të reja të punës.

4.2 Urbanizimi dhe zhvillimi urban i Komunës

LDK, në periudhën e ardhshme 4 vjeçare do të kushton vëmendje shumë të veçantë qështjeve urbanistike të cilat mund të thuhet se për momentin mund të quhen edhe si kaos urbanistik i cili është krijuar në mungesë të planeve strategjike zhvillimore në nivel të Kosovës poashtu edhe në nivele komunale. Për këtë këtu do të kenë rast që me këtë qështje do të marrin ekspert vendor por me mbështetje të eksperteve të huaj në realizimin e një plani të ri gjeneral urbanistik.

Plani ekzistues gjeneral i hartuar në vitin 2002 në masën më të madhe ka pësuar ndryshime prandaj edhe duhet të ketë një revidim apo të ketë një plan të ri.

Për këtë do të angazhohen ekspertë për të punuar planin zhvillimor komunal dhe planin urban të qytetit dhe ata do të vendosin për hapat e metutjeshëm edhe atë gjithmonë duke u bazuar në planet e hartuara zhvillimore dhe vizionet e paraqitura me herët për të ardhmen e komunës së Prizrenit.

Në qytetin e Prizrenit do të punohet në definimit e lagjeve të banuara dhe në mbulimin e të gjithë qytetit me plane urbanistike.

Brenda qytetit të Prizrenit do të ruhen ndërtimet e vjetra që paraqesin vlerë kulturore për Komunën e Prizrenit dhe për mbarë Kosovën.

Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet mbrojtjes së zonave të gjelbëruara në qytet si dhe gjenerimit të gjelbërimit të ri.

Në periudhën prej vitit 2006 është formuar një grup i eksperteve të fushave të ndryshme dhe ata të shoqëris civile dhe me mbikqyrjen e UN HABITAT ku ky projekt edhe ka përfunduar me emrin "Vizioni i Integruar i Prizrenit", ku Prizrenit i jep

Udhëzimi me emrin "Vizioni i Integruar i Prizrenit", i përgatitur nga Komuna e Prizrenit një rol të rëndësishëm si qendër e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me një ekonomi që krijon potenciale për zhvillimin e shoqërisë tolerante ku sundon ligji.

Dokumenti është i strukturuar në pesë fusha kryesore të intervenimit në aspekt të zhvillimit komunal. Këto pesë fusha të intervenimit janë:

- **Zhvillimi Urban dhe Rural dhe Planifikimi**
- **Trashëgimia Kulturore dhe Burimet Natyrore**
- **Lëvizshmëria dhe Transporti**
- **Mjedisi ekonomik dhe Bujqësia,**
- **Infrastruktura dhe Shërbimet**

- **Zhvillimi dhe planifikimi urban dhe ai rural.**

Qëllimi i parë është paraqitja e zhvillimit urban të organizuar dhe implementimi i përdorimit racional të tokës me qëllim të paraqitjes së organizmit të qëndrueshëm të vendbanimeve, përmirësimi i kushteve jetësore, përdorimi efikas i burimeve ekzistuese kryesisht toka dhe infrastruktura dhe përdorimi i duhur i tokës bujqësore.

Qëllimi i dytë është themelimi dhe përkrahja e skemës së zhvillimit hapësinor policentrik në sipërfaqen e komunës së Prizrenit për përkrahjen e zhvillimit më të balancuar në mes të qendrës kryesore dhe qendrave më të vogla në zonën rurale, për ndërtimin e partneritetit të zhvillimit urban-rural dhe të ul shtypjen e urbanizimit në qytetin e Prizrenit.

- **Fushat e veprimit janë :**

- Përgatitja e planeve rregulluese për zgjerimet urbane, rregullimi i vendbanimeve joformale përfshirë përmirësimin e infrastrukturës
- Zhvillimi i hapësirave të gjelbra në zonat zhvillimore
- Identifikimi i nën-qendrave si pole për zhvillim në zonën rurale
- Identifikimi i vendeve për aktivitetet ekonomike kryesisht për Industrinë e lehtë, Shërbimet dhe Tregtinë
- Përgatitja e planeve zhvillimore për nën-qendrat dhe pjesët nënurbane përgjatë arterieve kryesore të trafikut.
- Përmirësimi i infrastrukturës sociale, kulturore dhe teknike në nën-qendra

- **Trashëgimia Kulturore dhe Burimet Natyrore**

Synimi i saj është mbrojtja dhe valorizimi i trashëgimisë kulturore në pjesët urbane dhe rurale po ashtu edhe i burimeve natyrore si tipare të rëndësishme të komunës.

- Fushat e veprimit janë:

- Valorizimi i burimeve natyrore kryesisht Parku Nacional Malet e Sharrit
- Përpunimi i planeve të mbrojtjes dhe zhvillimore bazë për financim të jashtëm
- Integrimi i planit të konservimit për zonën historike në skemën e planifikimit urban
- Zhvillimi i strukturës implementuese për t'i arritur objektivat e planit të konservimit (grupi i ekspertëve, vetëdijesimi i popullatës, nxitja)
- Integrimi i Prizrenit në rrjetin Evropian dhe shkëmbimi i përvojave

- **Lëvizshmëria dhe Transporti**

Synimi i saj është përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit regjional për përkrahjen e zhvillimit në pjesët rurale dhe zhvillimin policentrik përmes qasjes së lehtë në infrastrukturë dhe shërbime të ofruara në nën-qendra. Është sugjeruar zgjerimi dhe rregullimi i rrjetit të transportit ndërshtetëror me qëllim për ta lidhur komunën me vendet fqinje të regjionit dhe për ta lehtësuar shkëmbimin e mallrave. Pos kësaj, ky intervenim siguron përkrahjen e lëvizshmërisë private dhe publike të sigurt dhe të përshtatshme në qendrën urbane dhe përmirësimin e trafikut urban dhe parkingut, kryesisht në qendrën historike.

- Fushat e veprimit janë:
 - Rregullimi dhe zgjerimi i rrugëve që lidhin qendrën me nën-qendrat;
 - Lidhje më të mirë dhe qasje në zonat e burimeve natyrore;
 - Përmirësimi i sistemit të transportit publik për ta lidhur regjionin me qendrën urbane të Prizrenit (rrjeti i transportit lokal-regjional);
 - Rregullimi i hekurudhës për transportin e udhëtarëve dhe mallrave;
 - Lidhja më e mirë me Jugun/Maqedoni nëpërmjet Reçanës – Lubinje e Poshtme – Brodic (Maqedoni);
 - Rregullimi dhe riorganizimi i rrugëve dhe hapësirave publike për ta përmirësuar sigurinë dhe komfortin për këmbësorët, çiklistët dhe personat me aftësi të kufizuara;
 - Rregullimi i parkingut në zonën historike përmes paraqitjes së hapësirës shtesë për parking dhe menaxhim të vendit për parking;
 - Zhvillimi i konceptit të transportit publik urban dhe themelimi i stacioneve multimodale (të ndërrimit) dhe lidhja me transportin regjional;
 - Analiza e realizueshmërisë ekonomike dhe teknike të Teleferikut Marash – Kala.

- **Mjedisi ekonomik dhe Bujqësia**

Synimi i saj është përgatitja e infrastrukturës së “butë e të fortë” për përkrahjen e aktiviteteve private dhe investimeve, përkrahja e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale, zhvillimi i politikave bujqësore në nivelin regjional.

- Fushat e veprimit janë:
 - Përkrahja e rrjetit të bizneseve lokale dhe të jashtme dhe lehtësimi shkëmbimeve;
 - Marketingu dhe rritja e kualitetit të produkteve lokale për krijimin e mundësisë së eksportit;
 - Përkujdesje e tokës së zhvilluar dhe shërbyese për aktivitetet ekonomike si zhvillimin e vendeve të reja në një lokacion të ri duke marrë parasysh trafikun për lidhje në Qytet dhe nën-qendra;
 - Ri-zhvillimi i vendeve ekzistuese të ish ndërmarrjeve shoqërore;
 - Përmirësimi i infrastrukturës rurale në pajtim me zhvillimin e aktiviteteve bujqësore dhe prodhimin e ushqimit;
 - Sigurimi dhe mundësimi i lokacionit për aktivitetet blegtorale;
 - Përkrahja e prodhimeve ekologjike dhe përkrahja e kultivimit të bimëve mjekësore;
 - Organizimi i strukturës menaxhuese dhe financuese për rregullimin e sistemit të ujitjes;
 - Zhvillimi i potencialit ekonomik në zonat e trashëgimisë kulturore dhe burimeve natyrore për turizëm dhe rekreacional.

- **Infrastruktura dhe Shërbimet Publike**

Synon përmirësimin e kualitetit të shërbimeve publike, ngritjen e kapacitetit dhe kualitetit të infrastrukturës teknike dhe zgjerimin e shërbimeve publike dhe infrastrukturës.

- Fushat e veprimit janë:
 - Përmirësimi i kualitetit të arsimit/ Shkëmbim përvojash;
 - Përmirësimi i shërbimeve mjekësore;

- Menaxhimi dhe riciklimi i mbeturinave në zonën urbane dhe rurale;
- Përmirësimi i Ujësjellësit;
- Ndërtimi i Impiantit dhe trajtimi i ujërave të zeza;
- Furnizimi me Energji Elektrike dhe shërbimet e tele-komunikimit sipas standardeve Evropiane;
- Hulumtimi i kapacitetit të burimeve alternative të energjisë elektrike si uji, mullinjtë e erës;
- Ndërtimi i hidrocentralit të Zhurit;
- Rregullimi dhe ndërtimi i objekteve shkollore;
- Qendrat për Mjekësi Familjare;
- Ndërtimi i qendrës së artit vizual-kulturor/ Teatër/ Kinema;
- Vende (hapësira) për persona me aftësi të kufizuara;
- Themelimi i universitetit të ri;
- Ndërtesa për banim social.

➤ **Rekomandimet e Vizionit të integruar të Prizrenit për përpunimin e PZHKP 2025 janë:**

- Pasqyrimi i situatës së shfrytëzimit të tokës ekzistuese për pjesën urbane dhe nënurbane të qytetit të Prizrenit;
- Përcaktimi i nën-qendrave si bazë e implementimit të sistemit policentrik dhe të zhvillimit hapësinor më të balancuar të bazuar në popullatë, zhvillim të popullatës, lokacionin, qasjen, funksionet ekzistuese publike;
- Lidhja e transportit publik lokal me atë regjional për t'i përkrahur si pjesët rurale po ashtu edhe qendrën urbane;
- Analiza dhe vlerësimi i trashëgimisë kulturore në pjesët rurale;
- Përkrahja e planit ekzistues i konservimit për zonën historike të Prizrenit me masa të realizueshme të implementimit që reflektojnë kryesisht kapacitetin privat dhe publik për menaxhim dhe financim;
- Integrimi i planeve lokale duhet të identifikohen në kornizën e projektit të strategjisë zhvillimore Lokale e financuar nga BE në regjionin e Zhupës, Anadrinit dhe zona verilindore bujqësore;
- Zhvillimi i zonave specifike për industrinë e lehtë dhe aktivitetet afariste duke reviduar planin ekzistues të zhvillimit urban;
- Mundësitë e bashkëpunimit ndër-komunal dhe ndër-regjional sa i përket shkëmbimeve ekonomike dhe rrjetave, bashkëpunimi i ngushtë në projektet e infrastrukturës dhe lidhjet sa i përket rrjetit të transportimit;
- Identifikimi I prioriteteve për investime në infrastrukturë lidhur me konceptin e planifikimit për zonat urbane dhe nën-qendrat;
- Zhvillimit i popullsisë, më shumë në pjesët rurale më të largëta me masa të përshtatshme për shqyrtimin e zvogëlimit të popullatës dhe nevojës për të ruajtur një standard themelor të shërbimeve publike.

4.3 Sektori i Arsimit

LDK dega në Prizren , në misionin e vet për Arsimin ka ndertimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës që siguron kushte për formimin cilësor të të gjithë individëve duke kultivuar shprehi të të nxëniet gjatë gjithë jetës me vlera të qytetarisë demokratike. Ne do të punojmë që Prizreni të jetë shoqëri e dijes e integruar në rrjedha evropiane me mundësi të barabarta për zhvillim personal që synon të nxënësit gjatë gjithë jetës për të gjithë individët të cilët i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik – shoqëror.

Analiza e Përgjithshme te gjendjes

▪ Përparsit

- Struktura kualifikuese e arsimtarëve;
- Kreativiteti i arsimtarëve;
- Gadishmëria e arsimtarëve për përsosje profesionale – rikualifikim;
- Predispozitat intelektuale të fëmijëve;
- Gadishmëria e prindërve për bashkpunim me shkollën;
- Gadishmëria e Komunës, MASHT-it për investime kapitale në infrastrukturë shkollore;
- Gadishmëria e partnerëve ndërkombëtar për ta ndihmuar shkollën – arsimin (Banka Botërore, USAID, UNESCO etj.)
- Opinioni pozitiv për shkollën.

▪ Të Metat

- Hapsira e pamjaftushme shkollore;
- Hapsira jo e përshtatshme dhe jo e sigurt shkollore;
- Mungesa e ambienteve të përshtatshme për edukimin fizik – shëndetësor të nxënësve;
- Mungesa e hapsirave gjelbëruese – kopshteve shkollore, në shkolla;
- Mungesa e mjeteve dhe teknologjive bashkohore mësimore (kabineteve);
- Mungesa e Mediatekave shkollore;
- Mungesa e bibliotekave shkollore;
- Mungesa e literaturës profesionale për arsimtarët;
- Infrastruktura ligjore jo e përshtatshme;
- Pozita jo e mirë materiale e punëtorëve arsimor;
- Mosorganizimi në nivel të duhur i mësimit parafillor;
- Mungesa e organizimit të mësimit inkluziv – gjithëpërfshirës
- Shkalla e lartë e braktisjes së shkollimit obligativ (I – IX) diku rreth 1 – 1.5 %
- Politizimi i arsimit;
- Sistemi jofunksional për monitorimin e nivelit të mesimdhënis dhe të nxëniet në shkolle;
- Mungesa e lokacionit për objekte të reja;

- Prizreni, qytet i dijes, i inkuadruar në rrjedhat kosovare dhe evropiane me mundësi të barabart për zhvillimin personal të të gjithë individëve, të cilët kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.

- Ndërtimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formimin cilësor të të gjithë nxënësve dhe individëve, duke kultivuar shprehi të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe vlera të qytetarisë demokrtike
- Objektivat strategjike zhvillimore te arsimit ne Prizren per vitet 2010 – 2013
 - Mjedisë fizikë të mjaftushëm, të përshtatshëm, terheqës dhe të sigurt;
 - Mjete dhe teknologji bashkohore mësimore;
 - Gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim i diversitetit në arsim;
 - Mësimdhënie dhe te nxenit konform standardeve te kohes – mesimdhënie interaktive
 - Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor e efikas në arsim;
- **Masat dhe Aktivitetet**
 - Ndërtimi i godinave të reja shkollore;
 - Ndërtimi i hapësirave të reja – shtesë (anekse) të godinave shkollore;
 - Adaptimi (përshtatja) dhe riparimi i godinave ekzistuese shkollore;
 - Rregullimi dhe riparimi i infrastrukturës bazike shkollore (ujit të pijshëm, sistemit të ngrohjes, sistemit të ujërave të zeza, rregullimi i nyjeve hidrosanitare) ;
 - Ndërtimi i sallave të edukimit fizik dhe shëndetsor ;
 - Rregullimi i poligoneve sportive ;
 - Rregullimi i rrethojave të objekteve shkollore;
 - Rregullimi i ambientit të jashtëm shkollor;
 - Hapësirat gjelbëruese shkollore – kopshtet shkollore;
- **Treguesit për te ardhmen**
 - Gjerë në fund të vitit 2013, procesi mësimor – edukativ zhvillohet në të gjitha shkollat e komunës në më së shumti dy ndërrime dhe numri i nxënësve në paralele është jo më shumë se 25 nxënës.
 - Gjerë në vitin 2013 sigurohet infarstrukura bazike (themelore) e nevojshme për të gjitha shkollat e komunës: uji i pishëm, sistemi i ngrohjes, ujërat e zeza, nyjet hidrosanitare ...
 - Gjerë në vitin 2013 sigurohen hapsirat e nevojshme për realizimin e mësimimit praktik në të gjitha shkollat e mesme profesionale te komunes;
 - Në të gjitha shkollat e komunës gjerë në vitin 2013 krijohen kushtet elementare për të zhvilluar aktivitete fizike dhe shëndetësore;
 - Të gjitha shkollat e komunës gjerë në vitin 2013 do të kenëtë siguruar me rrethojë (metalike apo të ngjajshme) objektet e tyre shkollore;
 - Paisja e shkollave me mjete elementare të konkretizimit, për të gjitha lëndët mësimore gjere ne fund te vitit 2010;
 - Paisja e shkollave me mjete dhe teknologji bashkohore didaktike – mësimore : llaptop, kompjuter , skaner, kinoprojektor, videoprojektor, grafoskop etj – gjere ne fund te vitit 2013.
 - Paisja e shkollave me kabinetet të shkencave të natyrës - 2013;
 - Paisja e shkollave me kabinetin e informatikës- 2013;
 - Paisja e shkollave me kabinetin e gjuhëve të huaja - 2013;
 - Paisja e shkollave me mediateka shkollore (në Prizren së paku 5 mediateka dhe në vendabime të mëdha rurale) - 2013 ;
 - Të gjitha bibliotekat shkollore paisen me lektyra shkollore konform kurikulit të ri - 2010 ;
 - Gjer në fund të vitit 2013 në mbi 70% të shkollave të komunës do të hapen klasat për nivelin parafillorë ;

- Organizohen aktivitete për vetëdijesimin e prindërve dhe të komunitetit për rëndësin e arsimit të fëmijëve përmes fushatave, seminareve, trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme mediale – vizive dhe të shkruara, për regjistrimin dhe parandalimin e braktisjes së shkollës;
- Komuna organizon, mbështet dhe stimulon forma dhe programe alternative për shkollimin – arsimin joformal në nivelin I dhe II, në përputhje me politikat e MASHT-it;
- Komuna në bashkpunim me shkollat, emron komisionet shkollore për parandalimin mosregjistrimin dhe braktisjen e shkollës nga nxënësit në arsimin e obliguar, konform politikave të MASHT-it, aty ku ka nevojë;
- Komuna dhe shkollat do të krijojnë një sistem informacioni elektronik kthyes (Fid bek) i cili në çdo çast mundëson informacionet mbi numrin e nxënësve në shkollat e komunës, numrin e atyre që kalojnë nga një shkollë në shkollën tjetër apo për ndonjë arsye braktisin shkollimin e obliguar apo atë të nivelit III.
- Komuna ndërton (përpilon) një database për nxënësit e saj, që kanë braktisur shkollën ose që kanë prirje të tillë, duke specifikuar arsye që e favorizojnë këtë dukuri;
- Komuna do të sigurojë rrjetin e transportit për nxënësit nga zonat e thella rurale dhe në periferi të qytetit në mënyrë që të rritet vijueshmëria e nxënësve në shkollë;
- Në përputhje me politikat e MASHT-it do të hapen drejtime të reja për nxënësit e shkollave të mesme profesionale;
- Komuna do të organizoj trajnimin e të gjithë mësimdhënësve, niveli I, II dhe III (të cilët nuk janë të çertifikuar – trajnuar) për mësimdhënie me strategji interaktive;
- Trajnimi i mësuesëve për punë me nxënës me nevoja të veçanta – mesim inkluziv;
- Komuna (DKASH) do të organizoj takime në formë punëtorish, seminare dhe forma të tjera për çështje të ndryshme nga fushën e arsimit, me pjesëmarrje të ekspertëve lokal dhe atyre të MASHT-it;
- Komuna dhe shkollat do të thellojnë bashkpunimin me komunitetin e prindërve, në veçanti do t'i kushtohet kujdes funksionalizimit të Keshillit të Shkollës dhe Komuna dhe shkollat në vazhdimsi (në mënyrë periodike) do të njoftojnë prindërit dhe komunitetin me arritshmërinë e nxënësve në shkollë;
- Në shkollat e komunës gjere në vitin 2013 do të funksionalizohen shërbimet profesionale shkollore (pedagogu, psikologu, mjeku, sipas politikave të MASHT-it);
- Komuna (DKASH) do të nxjerr gazetën arsimore periodike “Shkolla”.
- Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor e efikas në arsim
- Komuna do të ju ndihmojë institucioneve arsimore që deri në fund të vitit 2010 t'i kenë të harmonizuara me dispozitat ligjore, aktet e tyre themelore normative shkollore
- DKASH do të përgatis projektpropozime për rregullore të reja për jetën dhe punën në shkollë;
- DKASH do të krijoj mekanizma ligjor të cilët mundësojnë monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë sistematike zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në të gjitha institucionet arsimore komunale;
- Komuna do të ndërtoj infrastruktur të avancuar për përpunimin e të dhënave (softuer dhe infrastruktur tjetër fizike për SMIA -sistemi menaxhimit dhe informimit në arsim, në nivel të komunës dhe të lidhjes me MASHT)
- Komuna do të organizoj trajnime për drejtoret e shkollave për udhëheqje dhe menaxhim efikas dhe cilësor të shkollave, për vëtvlerësim të performancës së punës në shkollë, për monitorim dhe hospitim në procesin e mësimdhënies, për hartimin e planeve zhvillimore të shkollës, për hartimin dhe menaxhimin e buxhetit vjetor të shkollës etj;
- DKASH do të organizoj takime të rregullta konsultative DKASH – Shkolla - Prinder;

▪ **Përmbledhja Ekzekutive**

- Aktualisht (2009) në Komunën e Prizrenit, mësimet në nivelin parafillor – mosha 5 – 6 vjeçare (niveli 0) i vijnë 1082 fëmijë (pa llogaritur numrin e fëmijëve të cilët i vijnë mësimet në entet parashkollore private dhe të pazyrtarizuara – mbi 10 sosh),
- Në nivelin I dhe II përkatësisht në arsimin e obliguar (kl. I – IX) mësimet i vijnë gjithësejtë 31114 nx, të shpërndar në 1301 paralele me gjithësejt 41 shkolla amë dhe 33 paralele të ndara fizike dhe në nivelin III (kl. X – XII) mësimet i vijnë 7852 nxëmës të shpërndar në 255 paralele me gjithësejt 5 shkolla amë dhe 7 paralele të ndara fizike. Procesi mësimor – edukativ zhvillohet në tri gjuhë mësimore : shqipe, turke dhe boshnjake.
- Procesi mësimor – edukativ me këta nxënës e zhvillojnë: në nivelin parafillor 22 edukatore, në nivelin I dhe II 1529 mësimdhënës dhe 456 mësimdhënës në nivelin III.
- Në Komunën e Prizrenit funksionojnë edhe dy shkolla speciale : Qendra Shkollore për Arsimimin dhe Edukimin e Fëmijëve me të Meta të Lehta Mentale “Lef Nosi” dhe Shkolla Speciale për Fëmijë me të Meta në të Degjuar dhe të Folur “ Nëna Terezë” dhe Konvikti për Nxënës dhe Student.
- Për nivelin I dhe II (arsimin obligativ) momentalisht janë në dispozicion 72 mijë m/2 hapsirë shkollore (mësonjëtoare dhe dhoma të tjera si kabinete...), rreth 280 mijë m/2 oborr shkollor, 31 fusha sportive, 10 salla të edukatës fizike etj. Ndërsa për nivelin III momentalisht janë në dispozicion mbi 15 mijë m/2 hapsirë shkollore, mbi 15 mijë m/2 oborr shkollor dhe 3 salla të edukatës fizike.

4.4 Sektori i Shëndetësisë

Mision i **LDK**-së për Prizren është “Zhvillimi i sistemit të qëndrueshëm shëndetësor i cili të ofroj shërbime cilësore për të gjithë banorët e Republikës së Kosovës me synimin e arritjes së standardeve bashkëkohore”.

Shëndetësinë është që të zhvillojë dhe të siguroj sistem efektiv dhe efikas të shërbimeve shëndetësore të kualitetit të lartë që plotëson nevojat e tërë popullatës së Komunës së Prizrenit , pa marrë parasysh origjinën etnike, religjionin ose gjininë, dhe të përmirësoj statusin e përgjithshëm shëndetësor përmes:

- Zhvillimit të politikës dhe këshillës profesionale për shërbimet shëndetësore duke siguruar këshillë më të mirë profesionale për zhvillimin e politikës, rregulloreve dhe standardeve lidhur me shërbimet shëndetësore, posaçërisht përmes shërbimeve shëndetësore parandaluese;
- Menaxhimit Strategjik duke siguruar kornizë menaxhuese për zhvillimin e shërbimeve shëndetësore të qëndrueshme dhe të cilat përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme dhe duke i përkrahur ato përmes zhvillimit të potencialit njerëzor, menaxhimit të kualitetit, koordinimit të investimeve dhe sistemeve informative; dhe
- Menaxhimit Operativ duke siguruar ofrimin e shërbimeve publike kualitative dhe të lëvërdishme të kujdesit shëndetësor parësor në institucionet shëndetësore.

▪ Situata aktuale

Komuna e Prizrenit është një nder komunat ne te cilen ne baze te masterplanit të objekteve shëndetësore i cili bazohet ne standardet te parapara qysh ne periudhen prej vitit 2003-2007 ,në masen me te madhe e ka permbyllur rrjetin e institucioneve shëndetsore te cilat duhet ti ketë. Me kalimin e viteve vështirësit e vazhdueshme dhe zgjërimi i rrjetit te institucioneve pa kriteret dhe

standarte (ne dy vitet e fundit)te parapara kanë berë qe kualiteti i punës dhe mirëmbajtja te bjerë në një intenzitet te shtuar te cilat kanë pru në një ramje te kualitetit te shërbimeve.

▪ **Vështirësit**

- Mungesa e resurseve profesionale(mjekëve dhe specialistëve);
- Imlementimi i mangët i ligjit;
- Monitorimi dhe llogaridhënia ne nivel te ulet;
- Sisteme joadekuante te menagjimit;
- Mungesa në furnizim te mjaftueshëm me barna dhe material shpënzues;
- Fondet e kufizuara;
- Sistemi joadekuat i informimit shëndetësor;
- Sistemi jo i kenaqshëm i referimit.

▪ **Masat dhe Aktivitetet**

- **LDK**-ja në Prizren perkrah fuqishëm kujdesin parësor shëndetësor te mbeshtetur ne konceptin e mjekësisë familjare ashtu siq parashihet me ligj për shëndetësi dhe strategjin mjekësore për Kosovën;
- Të zvogëloj mortalitetin dhe morbiditetin e fëmijëve në moshën pesë veçare , morbiditetin maternal dhe të rrisë shkallën e imunizimit;
- Të zvogëloj pirjen e duhanit me theks të posaçëm te të rinjët dhe të parandaloj varësin ndaj drogës dhe sjelljet e rrezikshme me theks të veçantë në popullësin e moshës së re;
- Përmirësimi i shëndetit mendor duke zhvilluar shërbime të shëndetit mendor të bazuar në komunitet dhe të ndaloj shkallën e incidencës së vetëvrasjeve dhe tentim vetëvrasjeve;
- Të forcoj kapacitetin në të gjithë sektorët e shëndetësisë përmes zhvillimit të potencialit njerëzor në përputhje me reformat e propozuara të kujdesit shëndetësor;

➤ **Për periudhën e ardhshme katër vjeqare të qeverisjes lokale në komunën e Prizrenit, në fushën e Shëndetësisë LDK-ja parasheh:**

- Zgjerimi i infrastrukturës shëndetësore ku në shumicën e fshatërave në komunën tonë të ketë ambulancë të mjekësisë familjare, ku do të punoj tekniku medicinal çdo ditë, ndërkaq mjeku së paku dy herë në javë;
- Zhvillimi i ekipit për edukatë shëndetësore ku parashohim që të përmes ekipit për edukatë shëndetësore të organizojmë ligjerata për të rinjët në të cilat do të ligjerohen tema të rëndësishme për ruajtjen e shëndetit nga dukurit negative si përdorimi i drogës, pirja e duhanit, do të njoftohen me sëmundjet e rënda si që është AIDS etj. Ligjeratat parashihet të mbahen në mënyrë sistematike në shkolla dhe në bashkësi lokale nëpër fshatra.
- Përforcimi i shërbimeve shëndetësore parësore përmes konceptit të mjekësisë familjare, mundësimi dhe ofrimi i kushteve mjekëve për specializim në këtë lëmi. Mbjajtja e ligjeratave për edukimin e vazhdueshëm profesional për stafin mjekësor dhe infermierik me anë të të cilave do të freskohen njohuritë lidhur me shërbimet shëndetësore parësore.
- Renovomi i ish Fiziatriisë ne QMF-1;

- Ndërtimi i ambulancës në fshatin Landovicë;
- Ndërtimi i një furre për djegje të materialit medicinal;
- Ndërtimi i ambulancës në fshatin Petrovë-Therandë;
- Ndërtimi i QMF-së në Ortakoll;
- Mirëmbajtje dhe renovime të QMF-ve.

4.5 Sektori i Bujqësisë

LDK me punën e vet studiuse dhe hulumtuese në terren dhe në baze të resurseve klimatike, tokësore dhe profesionale kanë arritur në përfundim se sektori i bujqësisë është sektori më i përshtatshëm ku mund të punësohen një numër i madh i të rinjve dhe me këtë edhe të krijohej një mireqenie familjare. Në për mandatin e ardhshëm planifikojmë që përmes këtyre formave të prezentuara më poshtë do të ringjallim bujqësinë në komunën tonë:

Nëse deri më tani jemi arsyetuar se bujqësia nuk duhet jetë në rend të parë të zhvillimit ekonomik në Kosovë është dal nga lufta dhe duhet kaluar fazën emergjente; kjo nuk mund të thuhet tani e tutje kur dihet se kanë kaluar 10 vite pas lufte dhe bujqësia nuk e ka vendin aty ku e meriton.

Është koha që të kthehemi kësaj dege nga se si çdo vend që zhvillimin ekonomik e nis me zhvillimin e bujqësisë edhe në duhet të nisemi dhe të investojmë në këtë degë kur dihet se më se lehtë është që të hapet një vendë pune në bujqësi.

Është e vërtetë se mundësitë e komunave janë të limituara për investime në bujqësi por kjo nuk do të thotë se nuk duhet kushtuar rëndësinë që e meriton.

Komuna jonë është e veçantë dhe dallohet me kompleksitetin sa i përket resurseve bujqësore.

- Pra ka tokë të plleshme (10.000 ha) ,
- Sipërfaqe të përshtatshme për kultivimin e vreshtave _ për 3000 ha ,
- Ka kullosa të mjaftueshme për 15.000 krerë lopë dhe 20.000 krerë dele.
- Ka mundësi të mëdha për zhvillimin e pemëtarisë , perimeve, kemi 24.000 ha pyje.

Këto kapacitete për momentin shfrytëzohen vetëm 30% dhe kjo është ajo për të cilën duhet të mendojmë dhe punojmë.

Po e përsëris se më së paku duhet investime (mjete financiare) për hapjen e një vendë pune në bujqësi). Programi i zhvillimit të bujqësisë në komunën tonë duhet të jetë i harmonizuar me atë të Qeverisë - Ministrisë së Bujqësisë nga se atje janë të vendosura kornizat e përgjithshme dhe në bazë të asaj zhvillohen edhe objektivat e qeverive komunale të cilat në bazë të fuqisë ekonomike i realizojnë ato. Ministria e Bujqësisë ka “ **Plani e zhvillimit rural –Master Planin”2007-2013**, ku duket të bazohet zhvillimi i bujqësisë , deri më tani nga Kuvendi janë hartuar disa ligje të cilat presin zbatim dhe që e shtynë këtë degë të jetë konkurente me ato nga shtetet e rajonit.(Ligji për tokat bujqësore, ligji për mbrojtjen e kafshëve, Ligji i veterinarisë, Ligji mbi pyjet, Ligji për fareëra etj.)

Shumë kompetenca në sferën e bujqësisë deri më tani kanë qenë të pa qarta dhe të centralizuara por me daljen e ligjeve sidomos të atij për Vetqeverisjen pushtetit Lokal dhe fillimi i zbatimit të Decentralizimit aty ku qartësohen dhe kanalizohen.

Duke u bazuar në përshkrimin e profilit mbi resurseve bujqësore që i cekëm më lartë ,me të cilat mburërit komuna jonë ; mbi këto duhet të bazohemi në realizimin e objektivave që Brenda periudhës 5 vjeqare këto kapacitete të shfrytëzohen deri në 70% dhe këto do të arrihen me një punë intensive dhe në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë faktorët relevant: Qeverinë, Ministrinë e bujqësisë , Instucionet e ndryshme financiare vendore dhe ndërkombëtare.

- *Mendojmë se **LDK-ja** do të bëjë maksimumin që bujqësinë ta avancojmë dhe oja të zë vendin që e meriton, dhe për këtë që ti arritë qëllimin tonë duhet ti realizojmë Objektivat e programit që janë:*
- Mbrojtja e tokave bujqësore nga ; ndërtimet pa leje ,eksplotimet e inerteve nëpër tokat e bukës, si dhe aktivizimi i tokave djerrinë,
- Pregaditja dhe implementimi i projekteve me kosto të ulte dhe të mesme financiare për fermerët eksistencial dhe gjysëm komercial ku hynë numri më i madhe i tyre. Projektet do të kenë vlerë nga 15.000-30000 € dhe nga secili projekt do të përfitojnë se paku nga 10-15 ferma.

Këtu do të jetë shtylla kryesore ku duhet të përqëndrohemi pasi këtu bëjnë pjesa kategoritë më të ndieshme të fermerëve dhe kjo është edhe obligim i Qeverive Komunale.

Këto projete kryesishtë do të jenë në ngritjen e serrave, minishtallave, plantacioneve me pemë , infrastruktur bujqësore, Ngritjen e kapaciteteve profesionale, shërbimeve kshillimore etj.

- Rritja e standardit të jetës në ekonominë familjare nëpër vise rurale.
- Rritje e kontrollit të cilësisë së prodhimeve bujqësore.
- Përmisimi i infrastrukturës bujqësore..
- Përkrahje financiare dhe profesionale për të gjitha aktivitetet (panairët, manifestimet, kshillimet , seminarët) që kanë të bëjnë me avancimin e pozitës së fermerëve në shoqëri.
- Do të krijohet një fondë për intervenime në raste të fatkeqësive që ndodhin në ferma. (zjarret, vërshimet, sëmundjet)
- Organizimi i fermerëve nëpër shoqata bujqësore si zgjidhje e vetme për të qenë konkurent me fermerët e shteteve tjera.
- Do të planifikojmë dhe realizojmë rregullimin e kanaleve për ujitje të sipërfaqeve bujqësore aty ku ka mundësi ujitje dhe ku ka ujë të mjaftueshëm , me çka do të ngrisinë rendimentet e kulturave bujqësore .
- Do të krijojmë një fondë me të madh për luftimin e qenve endacak në komunën tonë , në mënyrë që të krijojmë siguri të qytetarëve
- Një bashkëpunim dhe pjesëmarrje në financim në projektet e përbashkëta me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e që janë në interes të Komunes. (projektet në sistemet e ujitjes së tokave bujqësore, ngritja e plantacioneve të mëdha, Subvencionet,)
- Mirëmbajtja e rrugëve fushore, shtruarja me zhavor të tyre.
- Kërkim donacionesh me qëllim të zgjerimit të sistemit të ujitjes në fshatrat e komunes.
- Ndërtimi i një tregu bujqësor në ndonjë fshat ku është pjesë me të zhvilluar e bujqësisë;
- Ndërtimi i pikave grumbulluese të qumështit në disa prej lokaliteteve më të mëdha të komunës.

4.6 Sektori për Kulturë,Rini,Sport dhe Turizëm

Duke pas parasyshë potencialin kulturor, rinor dhe sportivë të komunës sonë krijimi i strategjisë për zhvillim të kultures, rinisë dhe sportit është pjesë qenësore e platformës zgjedhore të **LDK-së**. Për secilën nga këto segmente **LDK** planifikon të zhvillojë një mori projektesh dhe aktivitete konkrete.

Prizreni është në pritje që të njihet për aspektet e saja pozitive siç janë potencialet natyrore, kulturore, historike dhe turistike.

Qytetit po ashtu ka nevojë të zgjedhë problemet e veçanta sa i përket, banimit, transportit dhe Infrastructures në këto fushë.

❖ Trashegimia kulturore

Perkunder trashegimise se madhe kulturore dhe potencialit qe e ka qyteti yne, shume pak apo fare nuk eshte punuar ne kete drejtim, si nje shtet pas tranzicionit, trazirave dhe prioriteteve tjera qe I ka pas qyteti, ne Prizren edhe pse nuk eshte investuar ne kete drejtim, se paku eshte dashur te ruhen vlerat e saj dhe te mos demtohet ne vazhdimesi deri ne ditet e sodit...

CHËB si dhe Universiteti Teknik I Stambollit si dhe profesionistet vendore tash me e kan realizuar planin detal urbanistik I ndare ne faza I cili pritet te realizohet.

Enti për mbrojtjen e monumenteve ka inventarizuar gjithsej 291 monumente kulturore në Komunë e Prizrenit. Qyteti ka më së shumti monumente dhe lokacione që përfaqësojnë sfondin historik të territorit të saj. Kalaja e Prizrenit është lokacioni më I rëndësishëm arkeologjik në Komunë dhe përcakton karakteristikat monumentale të Prizrenit sidomos nga shekujt 11-14. Ne Romajë dhe Kushnin ndodhen grumbuj gurësh që datojnë nga periudha parahistorike.

Edhe në Korishë, Nashec dhe Vlashnje gjenden mbetjet arkeologjike të fortifikatave. Numri I përgjithshëm I lokacioneve arkeologjike në Prizren është 24 dhe ato paraqesin shembujt e monumenteve antike dhe trashëgimisë arkeologjike që datojnë nga shekulli 1 deri në shekullin 14 të erës sonë.

Sipas klasifikimit të monumenteve arkitektonike, në Komunën e Prizrenit ndodhen 50 objekte publike që shfrytëzohen ose janë pronë publike shtetërore e Komunës së Prizrenit. Këtu hyjnë 5 objekte arsimore, 3 objekte të ambasadave, dhe një objekt shëndetësor që njihen si monumente arkitektonike në Prizren. Objektet tjera publike përfshijnë mullinjtë, krojet publike dhe objektet administrative. Si monumente me vlerë arkitektonike janë regjistruar edhe hidrocentrali, ndërtesa e vjetër e postës dhe ura e gurit në qendër të qytetit.

Në pjesën rurale të Komunës ka 24 objekte të regjistruara si monumente.

Qyteti i Prizrenit ka 66 objekte civile që shfaqin karakteristika tradicionale arkitektonike që shfrytëzohen nga banorët e saj. Pos këtyre objekteve, janë edhe 14 të tjera që ndodhen në fshatrat e Prizrenit.

Të gjitha lokacionet urbane dhe komplekset që janë regjistruar si tërësi e objekteve ndodhen në qytetin e Prizrenit. Thelbi i zonës së mbrojtur urbane të Prizrenit, që ka një plan urban të ruajtjes, (e përfunduar më 2007 dhe aprovuar më 2008) ka lokacione të ndryshme në listën e saj si p.sh. Muzeu i Lidhjes së Prizrenit, sheshi i Shatërvanit, Marashi dhe kompleksi i Nënkalasë. Duhet cekur edhe lokacionet tjera urbane te mbrojtura si sheshi i Karabashit, i gjimnazit Gjon Buzuku, dhe kompleksi i teqesë Sinani.

▪ Projektet qe do te ndermiren dhe zhvillohen

- Konzervimi dhe restaurimi I objekteve te trashegimise (kalaja, gjamite, muzete, hamami...) e qe do te behet ne faza. Projekti I pare do te jete (rruga e saraqeve deri te hamami) ne bashkepunim me UN habitatin dhe komunen. (projekte pjese pjese)
- Mbrojtja dhe zhvillimi I zones historike Kthimi I identitetit te zones se mbrojtur. (posaqerisht zones 1. shadervani-qendra, kalaja dhe nenkalaja)
- Ndriqimi, shenjezimi I tyre, pastrimi dhe mirmbajtja.

- Kthimi I lokaleve dhe objekteve ne origjinalitet dhe ti permbahen strikt elementeve dominuese si (kallderemi, guri, fasadat, vitrinat e drunjta dhe elementet tjera te punuara me standardet e kerkuara; asesi te mos perdoren materiale tjera ndertuese ne kete zone.
- Formimi I nje trupe komisioni profesionist “dashamiret e Prizrenit” – Drejtoria perkatese, qendra per mbrojtjen e monumenteve historike, perfaqesues profesioniste nga shoqata te arhitekteve dhe urbanistev si dhe perfaqesues nga shoqeria civile. (mbajne takime te rregullta dhe ngisin zerin per cdo paregullsi)

▪ **Projektet madhore (ne faza me afatgjate)**

- Zhvendosja e institucioneve nga qendra e qytetit: ne periferi si ATK, PTK, ish SDK-ja.
- Hapja e objekteve te trashegimise, ekspozimi I tyre – largimi I mureve dhe anekseve te ndertuara pereth tyre si ĘC, shupa, garazha.... (kryesisht, objektet fetare...)
- Planet ideore per rikthimin e lagjes Arasta te shkateruar nga regjimi komunist.
- Rindertimi I urave dhe zgjidhja per lagjen marash ne pajtim me komunitetin

▪ **Renovimet dhe ndertimet**

- Meremetimet dhe ndertimet ne qender mund te behen vetem me leje speciale nga institutet nen mbrojtjen e monumenteve si dhe paneli I profesionistev qe ne anje menyre most a demtoj harmonine e kesaj zone ku investitori duhet ti permbahet cdo detaji qe I eshte caktuar me rregullore.
- Reptesisht duhet te ndalohet ndertimi dhe rindertimi jashte normave si dhe vendosja e cfaredo objekti cofte edhe te perkohshem si ndriqim, billboard, reklama te ndryshme, simbole dhe elemente tjera qe cenojne vlerat e kesaj zone dhe nuk I permbahen kriterave te caktuara.
- Mbjtja e aktiviteteve qe e demtojne kete zone qofte edhe nje kubeze; duhet te ndalohen (p.sh garat me automobila, peshat e renda, ushtrimet e zjarfiksve...) dueht te kene leje perpos nga policia poashtu edhe nga perfaqesuesit e lartpermendur. Vetem ne kete menyre mund te ruhet dhe ngritet vetedija e qytetarit per vleren qe e ka ky shesh.

❖ **TURIZMI**

Nje pjese e pandashme qe lidhet ngushte me objektet e trashegimise se qytetit si dhe lashtesise se saj eshte **Turizmi kulturor** I cili do te zhvillohet proporcionalisht me projektet e lartepmendura per trashegimi poashtu.

Prizreni ka edhe potenciale te medha per zhvillimin e turizmit malor, turizmit fshatar si dhe ka edhe lumenjte si Drini ku mund te zhvillohen edhe aktivitete verore buze shtatit (vermica) qe nderlidhen edhe me sportet verore si dhe sportet dimerore (Prevalla dhe Brezovica)

Kujdes I veqante duhet ti jipet Turizmit e cila tani me hapjen e rruges Dures-Kukes rrit dukshem numrin e visitoreve edhe matane kufijve te cileve kemi shume pak tju ofrojme, si ne aspekt te akomodimit poashtu edhe ne nivel te ekspozimit dhe presantimit te vlerave te qytetit ne pergjithesi.

Pasi qe turizmi cdo vit e me shume ka rritje, mysafire dhe vizitore nga vende te ndryshme duhet te mobilizohemi qe te funksionojne ne nivel drejtorie apo ne hapjen e zyres turistike.

▪ **Detyrat e zyles (drejtorise)**

- Perfaqesimi I vlerave qe ka qyteti yne (guidat turistike, broshurat, aktivitetet dhe vizitat nepermes te agjencioneve, ngjarjet sportive si dhe aktivitetet kulturore dhe argetuese.)
- Akomodimi I turisteve si dhe vizitoreve.
- Informimi lidhur me krejt cka ofron qyteti si: objektet e trashegimise dhe kulturore, bukurite natyrore dhe lidhur me te gjitha aktivitetet, tadita, kultura, argetimi etj...
- Ciceronet

Kjo zyre turistike duhet te jete ure lidhese si dhe ne bashkepunim ne mes te K.K. Prizren, agjencive te ndryshme, OJQ, bisneseve si dhe qytetareve per mbarevajtjen si dhe harmoinizimin e te gjitha aktiviteteteve si ato kulturore dhe sportive si: (Zambaku I Pz, Fluturat, Aktivitete folklorike, SHKA te ndryshme, 40 bunar fest, shoqatat e ndryshme te antikuiteteve, street ball, turnire ne football ne regjionin e zhupes, shoqata e oldtimer-ave, si dhe ngjarja me e rendesishme kulturore DOKUFEST, qe mledh nje numer te madh te vizitoreve nga jasht.

Kjo zyre do ta bej presentimin dhe promovimin sa me te mire te qytetit per terheqjen e numrit sa me te madh te turisteve ndersa njeherit do te mund te vetmbahet dhe ti rrit te hyrat e zyles me sherbime qe do ti ofroj mu per ata turiste.

Kjo zyre me kohe do te specializohet dhe do ti percjell te dhenat, trendet e ritjes dhe zvogelimit te vizitoreve, si dhe te gjitha karakteristikave dhe detajeve me qellim qe punen e vete ta deshmoje si dhe ti pergjigjet kerkesave dhe risive per turistet ne vazhdimesi.

Turizmi ne te ardhmen e afert mund të bëhet një nga shtyllat kryesore të ekonomisë së Prizrenit.

*Jane elementet qe **LDK** I ka ne prioritet nga qe dhe I ka zhvilluar keto politika zhvillimore ne kooperim dhe koordinim me gjeneraten e reja, eksperte, shoqerite civile dhe pjesmaresit direct te ketyre aktiviteve.*

Pas projektit te renovimit te shtepise se kultures XH. Berisha ne Prizren dhe organizimit te teatrit profesionist dhe amator, **LDK** prët qe ne vazhdimesi ti promovojë vlerat e ketij qyteti, si dhe pas ndertimit te qendres kulturore (ish kino punetori), fillojm me nderimin e menjehershëm te kinemase lumbardhi (te mbyllur dhe te hapur) me qellim qe gjate aktiviteve te ndryshme verore te kemi sa me shume objekte ku mund ti akomodojme shikuesit tane, njeherit gjate festivaleve te medha do te mund te shfrytezohet edhe hapesirat dhe rruga e Saraqeve (te kinemaja lumbardhi) dhe Farkatareve dhe I tere kuarti te shfrytezohet per ngjarjet e medha kulturore.

Si jane perkrahur deri tash teatri dhe kinemaja poashtu do te perkrahim edhe aktivitetet tjera si ekspozita, klube te ndryshme, galerite etj.

Njeherit qellimi yne eshte qe ta marim primatin ne kete drejtim poashtu edhe organizimet kulturore qe ndodhin ne qytete tjera te mund ti bartim e nderlidhin ne te ardhmen aktivitetet e tyre me Prizrenin.

❖ SPORTI

Do te investohet dhe perkrahen projektet per ndertimin e qendrave sportive, inicohen dhe perkrahen te rinjet per zgjerimin e aktiviteve sportive si noti, skijimi, rely garat, krijimi I tereneve malore per motor cros ne pjesen e prevalles, hajking, ecje malore....

Si dhe bashkepunimi me kompanite private per inicim dhe perkrahje ne ndertimin e fushave te ndryshme sportive.

▪ PERFITIMET E KOMUNITETIT

Duhet te kemi partasysh se gershetimi I te gjitha ketyre elementeve prej trashegimise, investimet ne qendren e qytetit, investimi ne infrastrukturen ligjore si dhe asaj urbane, ritja e hapersirave per kembesore, qendrat kulturore, ekspozitat dhe galerite dhe aktivitetet rinore do te terheqin numer te madh te vizitoreve ku dhe do te kete perfitime sidomos ne lokalet dyqanet e kesaj zone dhe me gjere si dhe do te jete nje shtytes ne zhvillimin e artizanateve dhe prodhimtarise me c'gje nje numer I konsiderueshem I kesaj populatë do te mund te vetepunesohet si dhe rrit te ardhurat per nje pjese te konsiderueshme te popullates.

4.7 Sektori i Shërbimeve Publike

LDK –ja, ne këtë sektor ne periudhen e pasluftës ka arritur suksesest me të mëdha dhe ka një përvoj të jashtëzakonshme në menagjimin e mjeteve në ketë fushë e cila për shkakë te buxhetit edhe është me i ndieshme ne krahasim me sektorët tjerë.

Ofrimi i shërbimeve publike qytetarëve te Komunës se Prizrenit do te jete ne pajtim me ligjet dhe rregulloret e miratuara ne fuqi nga instancat kryesore lokale dhe qendrore te vendosjes.

Shërbimet duhet të jenë më cilësore nga ana e Kuvendit Komunal duke pas parasysh kalimin e kompetencave me të mëdha nga ndërmarrjet publike në kompetenca të Kuvendit Komunal edhe atë sipas ligjit të miratuar më herët.

Zgjerimi i shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimeve, ndërtimit të rrugëve, mirëmbajtjes së rrugëve, ndriçimit publik etj.

Shërbimet e veçanta do të jenë ato të rritjes së cilësisë së jetës në sektorin komunikacionit të përgjithshëm siç janë:

- Infrastruktura e përgjithshme rrugore;
- Sektori I Ambientit;
- Komunikacioni rrugor - Trafiku;
- Instalimet e Përgjithshme;
- Furnizimi me Ujë;
- Mirëmbajtja e Përgjithshme;

❖ **Infrastruktura e përgjithshme rrugore**

Në 4 vitet e ardhshme në këto sektore të cilat bënë pjesë në Drejtorin e Shërbimeve publike do të investohet me shumë kujdes pasi gjatë pasluftës ky segment ka qenë prioriteti kryesor. Duke patur parasysh se një pjesë e madhe e arterieve rrugore që lidhen me qytetin janë përfunduar dhe me gjase do të përfundohen, kjo nënkupton se pjesët kryesore janë të përfunduara. Projektet e filluara do të analizohen mirë se në cilën fazë kanë mbërritur dhe a do të ketë nevojë për revidim të projekteve ekzistuese.

Në kuadër të shërbimeve që lidhen me komunikacionin rrugor do të vazhdohet me vazhdimin dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve duke filluar nga;

- Analizat paraprake financiare të secilit projekt,
- Analizat e zgjidhjes teknike për secilin projekt të propozuar veç e veç
- Hartimin dhe revidimin e projekteve para realizimit të tyre
- Ndërtimin e objekteve dhe menaxhimin e mirë të tyre

Projektet në këto periudha 4 vjeqare nuk do të fillohen pa një analizë të përgjithshme të vetë projekteve dhe lidhshmërisë së tyre me planin gjeneral ekzistues dhe mundësinë e revidimit të këtij plani në sektorin e rrugëve pasi kemi edhe pjesë të këtij plani I cili nuk e përputhet me realitetin e ri të krijuar në terren.

Hartimi I projekteve do të punohet nga ndërmarrjet të specializuara dhe të deshmuara në këto sektorë dhe gjithësi revidimi I tyre para fillimit të ekzekutimit të projektit.

Projektet do të punohen nga ndërmarrjet të cilat I plotësojnë të gjitha kushtet të cilat I kërkon zyra e prokurimit dhe afatet për projektet e caktuara.

❖ **Sektori I Ambientit**

Ky segment ndoshta është edhe sektori që do të ketë vëmendje të veçantë pasi edhe lidhet me shumë qeshtje nderlidhese me kohën që pason e ku Kosova do të investon veqanarisht në periudhën e ardhshme.

Si nderlidhje është edhe kërkesa nga EU që Kosova duhet të investon në Ambient që është njëri prej kushteve kryesore për praninë në këtë mekanizëm të rëndësishëm, krijimi i ambientit me të mirë për qytetar, ngritja e nivelit higjienik në të gjithë Komunën dhe Brenda qytetit ku shërbimet komunale duhet të funksionojnë me ndryshje dhe adaptimi i ambientit me investimet e përgjithshme që janë bërë der më tani.

Të gjitha investimet të cilat do të bëhen paraprakisht do të bëhen në konsultime të përgjithshme me ekspert të kësaj lëmie dhe do të ketë takime me qytetar për të cilëve drejtperdrejt do të shihen nevojat kryesore të tyre.

❖ **Komunikacioni rrugor - Trafiku**

Rritja e numrit të automjeteve në periudhën e pasluftës ka ngritur shumë pyetje lidhur me organizimin e mirëfillt të komunikacionit, ku sidomos në qytetin e Prizrenit edhe atë në pjesë të vjetra ka ngarkesë të paperballueshme për shkak të frekuentimit të madh të makinave që hyjnë dhe dalin në qytet.

Nevoja e parë lidhet me problemin e parkimit të automjeteve ku parashihet ndërtimi i një parkingu nëntokësor ku njëri lokacion është parapare edhe atë në qendër të qytetit si dhe për lokacionet tjera do të vendoset në baze të nevojave dhe zhvillimeve të përgjithshme të qytetit.

Rëndësi e veçantë do të jetë rregullimi i qarkullimit të autobusëve lokal dhe atyre urban ku edhe kjo do të kalon në nivel të ekspertëve dhe në bashkëpunim me policinë e trafikut do krijohet një rregull sipas kërkesave dhe nevojave që do të krijohen në terren.

Pjesë tjetër e rëndësishme do të jetë edhe shenjëzimi horizontal dhe vertical i të gjitha rrugëve ekzistuese dhe atyre të reja në pjesët rurale dhe atyre Brenda qytetit e sidomos perkushtim i veçantë do të jepet pjesë së rrugëve ku qarkullojnë femijet pra rrugët që lidhen me shkollat.

▪ **Instalimet e Përgjithshme**

Me instalime nënkatpohen vendosja e rrjetit energjetik, ndriqimit public, instalimet hidroteknike (ujesjellesi dhe kanalizimet) si dhe instalimet tjera të nevojshme.

Për shkak të rëndësisë së veçantë që kanë instalimet e ujesjellesit dhe kanalizimit ato do të shqyrtohen veq e veq për nevojat që kanë fshatrat e Komunës së Prizrenit dhe në mënyrë të veçantë pjesët e qytetit ku këto lloj instalime nëntokësore mungojnë dhe që janë pjesa më e rëndësishme dhe jetike për banorët e Komunës.

Në këtë rast do të analizohet gjendja faktike e të gjitha projekteve të cilat janë përfunduar deri tani dhe projektet e reja të cilat duhet të fillohen.

Instalimet energjetike do të fokusohen në projektet e infrastrukurës rrugore të cilat janë pjesë e pandashme e këtyre projekteve dhe paralelisht me to edhe ndriqimi public ku për këtë do të përfshihen të gjitha pjesët e Komunës në përgjithësi.

▪ **Furnizimi me Ujë të pijes**

Një ndër shqetësimet me serioze që ndikon drejtpërsëdrejti në vet jetën e qytetarëve është padyshim sigurimi dhe furnizimi me ujë të pijes. Aktualisht qytetarët ballafaqohen me mungesë të kohëpaskohshme shpesh edhe me ndërprerje disaditëshe në shumë lagje dhe paralagje të qytetit. Kjo mungesë është edhe më drastike në fshatrat e integruaraq në rrjetin e ujësjellësit regjional. Kjo dukuri është shfaqur sidomos kohëve të fundit me tendencë të përkeqësimit të mëtutjeshëm. Janë shumë faktor që kanë determinuar këtë gjendje.

- Pozita gjeografike dhe konfiguracioni i terrenit të qytetit,
- rrjeti divergjues distributiv jofunksional
- kapaciteti i dobësuar furnizues në periudha të caktuara kohore,
- Natyra në përgjithësi dhe të reshurat atmosferike në veçanti dhe
- Invazioni migrues i popullatës nga fshati në qytet viteve të fundit që krijoi debalans urbanistik nga stagnimi i prurjeve të reja përkatësisht rritjen e kapacitetit prodhues të ujit gjersa në anën tjetër rritje enorme e numrit të konsumatorëve.

Peshën e veçantë në këtë mes pamëdyshje e merr qeveria lokale aktuale me indiferencën skajshme të treguar, duke mosangazhuar mekanizmat kompetent që direkt apo tërthorazi ndikojnë pëmbajtësisht në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijes.

Duke ushtruar detyrën e udhëheqësit të kompanisë regjionale ujore dhe duke patur përvojën paraparke në menaxhimin e projekteve të shumta infrastrukturore pata rastin e mirë në thellësi të njoftohem me këtë problem në të njëjtën kohë dhe të hulumtoj mundësitë eventuale për përmirësim. Dhe natyrisht mundësitë janë të shumta të dukshme dhe të prekshme.

Numri i popullatës që Kompania e Ujesjellesit Regjional ofron shërbimet e veta vlerësohet të jete rreth 200.000 banorë. Kapaciteti i përgjithshëm i prodhimit të ujit gjatë periudhës Prill - Gusht e cila konsiderohet kohë e prurjeve maksimale sillet rreth 820 l/sec gjersa periudha Shtator - Mars që konsiderohet si varfërim maksimal i prurjeve, sillet rreth 350 l/sec..

Furnizimi i qytetit dhe fshatrave brenda hapësirës menaxhuese të njësisë së Prizrenit sigurohet prej tri sistemeve të ndryshme:

- Me gravitacion, 50 %
- Me sistem pompimi, 35 %
- Me sistem filtrimi dhe përpunimi të ujit të Lumbardhit, 15 %

Për të patur njohuri solide rreth distribuimit dhe furnizimit, në vijim shpalos të dhëna të mjaftueshme dhe relevante të kësaj natyre.

- **Furnizimi me ujë nga "Burimi 40 Bunar"** -
Funkcionon optimalisht përmes gravitacionit. Furnizohet pjesa qendrore e qytetit, pjesa e poshtme, zona industriale dhe paralagjet "Bajram Curri" e "Arbana". Këto burime furnizojnë përafërsisht 70 % të qytetit apo rreth 110.000 banorë.
- **Furnizimi me ujë nga stacioni i pompimit "Bunarllëk I dhe II" –**

Këto dy burime furnizojnë zonën e epërme të qytetit respektivisht lagjeja "Dardania", Kazerma e KFOR-it dhe pjesa e epërme e lagjes "Bazhdarana". Këto burime furnizojnë përafërsisht 30 % të popullatës përkatësisht rreth 45.000 banorë.

▪ **Stacioni i sistemit të filtrimit të ujit nga lumi “Lumbardh” –**

Ky sistem furnizon me ujë një pjesë të paralogjeve “Arbana”, “Jeta e Re”, fshatrat “Landovicë”, “Atmagjë”, “Tupec”, “Nashec”, “Grazhdanik”, “Kobajë”, “Vlashnje” dhe kohë pas kohe zonën Industriale me lagjen “Bajram Curri”. Nga ky sistem furnizohen rreth 10.000 banorë.

▪ **Stacioni i pompimit “Sozi- Nashec” –**

Kryesisht furnizohet rajoni i Hasit respektivisht fshatrat “Gjonaj”, “Kojushë”, “Mazrek”, “Planejë”, “Gorozhup” dhe “Milaj”. Ky stacion furnizon rreth 4500 banorë.

▪ **Stacioni i pompimit “Vërmicë” –**

Nga ky sistem furnizohen fshatrat kufitare “Vërmicë”, “Shkozë” dhe Dogana shtetërore. Ky stacion furnizon rreth 2100 banorë.

Me përjashtim të stacionit të pompimit “Bunarllëk II” i cili është implementuar në vitin 2002, të gjitha sistemet tjera dhe kapacitetet prodhuese janë të nivelit të trashëguar nga e kaluara. Infrastruktura fizike e rrjetave distributive dhe furnizuese të ujit të pijes dhe kanalizimit ka vjetërsi rreth 40-50 vjeçare në gjendje kondicionale shumë të dobët. Pjesa dërmuese e tyre ka përmbajtje azbesti që shkaktojnë humbje të konsiderueshme të ujit dhe sipas të dhënave shkencore me ndikim kancerogjen.

Prandaj duke patur parasysh të dhënat e mësipërme, duke hulumtuar resurset dhe potencialet ekzistuese natyrore, duke mobilizuar mekanizmat institucional kompetent ekzistojnë mundësitë reale mbase të patjetërueshme për përmirësimin thelbësor të furnizimit me ujë të pijes.

Këto mundësi të shprehura në projektpropozime do të kishin karakter implementues afatmesëm dhe afatgjatë:

- Në burimin gravitacional 40 bunarët, një sasi e konsiderueshme e ujit, rreth 20-25 l/s nuk shfrytëzohet do të thot humbet.. Ndërtimi i një linje të re furnizuese nga kjo pikë deri te rezervuari i ri i ndërtuar do të furnizonte mjaftueshëm lagjen Dardania. Kjo do të mundësonte mënjanimin e furnizimit të kësaj lagje nga rrjeti aktual, me këtë sigurimin e mjaftueshëm dhe pa reduktime të ujit për lagjen Kurilla.. Meqenëse një pompë furnizuese ndër tjerat në stacionin pompues Bunari II funksionon për këtë lagje, automatikisht kjo pompë do të orientohet për furnizim gjegjësisht mbështetje rrjetit të qendrës së qytetit.. Në anën tjetër njëra pompë e stacionit pompues Bunari I që i ndihmon rrjetit do të orientohet në furnizimin e rezervoarit në Kala që e mbulon pjesën dërmuese të lagjes “Tusus” që shtrihen në nivelin e rezervoarit në fjalë.
- Me kolektimin e plotë të ujërave te Guri i Zi dhe ndërtimin e linjës së re furnizuese për rezervuarin “Cvileni” me sistem gravitacional do të sigurohet ujë i mjaftueshëm dhe pa reduktime për pjesën tjetër të lagjes “Tusus”.
- Me kolektimin e plotë të ujërave që supozohet të jenë rreth 30 l/s në burimin “Sozi Nashec”, do të sigurohet ujë i mjaftueshëm për regjionin e Hasit por edhe për pjesën e fshatrave që furnizohen nga rrjeti i qytetit (Nashec, Atmagjë, Arban[, etj). Me këtë projekt gjithashtu do të përfitonte qyteti sepse do të ndërpritej furnizimi nga rrjeti i qytetit për këto fshatra dhe do të furnizoheshin pjesët tjera të qytetit që aktualisht kanë mungesë.
- Ndërrimi i linjave kryesore furnizuese në rrugët dhe hapësirat ku nuk realizohen projekte rrugore për të evituar humbjet eventuale të ujit, eliminuar kyçjet ilegale dhe për të evituar ndikimin eventuale kancerogjen të gypave ekzistues nga azbesti.

- Sipas rrjedhave aktuale në sferën e legjislacionit, pritet që shumë shërbime institucionale me karakter qeveritar të transferohen në kompetenca komunale me ndikim të drejtpërdrejtë të autoritetit lokal. Kjo do të krijonte hapësirë të favorshme për mobilizimin e të gjithë mekanizmave relevant (gjyqësisë, policisë, inspektoratit) por edhe në rritjen e besimit qytetar për të dhënë kontributin në këtë drejtim. Do të krijohet një zinxhir ndëveprues i mbështetur me rregullore komunale për të disiplinuar kategoritë devijante të shoqërisë përkatësisht keqpërdoruesve të shërbimeve komunale në përgjithësi dhe te ujit të pijes në veçanti. Me këtë shërbimet komunale do të ngriteshin në nivelin optimal dhe sigurimi i ujit të pijes do të bëhet temë e tejkaluar.

Të gjitha këto aktivitete kërkojnë impenjimin e sigurt të qeverisë komunale, qeverisë qendrore por edhe të donatorëve dhe organizmave të tjerë potencial.

Këto janë një pjesë e projekteve të shumta që ka hartuar dhe harton në vijimësi qeveria komunale e ardhshme Muharremi.

❖ **Mirembajtja e Përgjithshme**

Mirembajtja është faza kryesore pas realizimit të projekteve që njekohësisht nënkupton edhe mbrojtjen e investimeve deri në një afat për të cilin mund të parashihet një projekt.

Ketu do të cekim pike se pari qeshtjen e mirembajtjes të projekteve të rrugëve të ndertuara me asfalt dhe rrugëve të ndertuara me kubza betoni. Rrugët për mirembajtje do të trajtohen edhe rrugët e ndertuara edhe paralufte edhe pas lufte. Në çdo vit do të kemi nga një ndërmarrje të kontraktuar me afat vjetor për mirembajtje të rrugëve me asfalt dhe në mënyrën e njëjtte edhe për rrugët me kubza betoni. Pastaj do të kushtohet rëndësi e veçantë edhe inspektimeve të kanaleve ekzistuese në qytet si ato të ujërave fekale dhe atyre për ujërat atmosferik, mirembajtjes së pusëve për dy llojet e kanaleve dhe ujembledhësve të cilat vende vende janë në gjendje të mjerueshme.

4.8 Lista e Projekteve 2010-2013

Ne vijim do te paraqesim listen e Projekteve kryesore te cilat LDK I ka ne programin e vete ne kater vitet e ardhshme per komunen e Prizrenit.

1. *Hartimi I projektit dhe ndërtimi i parkingut nëntoksore te qytetit me Koncesion*
2. *Projektimi dhe rregullimi i infrstruktures për varrezat e reja të qytetit*
3. *Dig (Reqan-Manastiric) për grumbullimin e ujrave natyrore për furnizim të qytetit*
4. *Ndertimi I kaskadave dhe rregullimi I shtratit te Lumbardhit*
5. *Menagjimi I mbeturinave dhe eliminimi I deponive ilegale*
6. *Zgjerimi I rruges Remzi Ademi ne pjesen qendrore te qytetit*
7. *Ndertimi I kinemas verore ne objektin ekzistues*
8. *Ndërtimi i Rrugës Tranzit i ri Magj. (Pz-Pr) - (Pz-Gjak)*
9. *Regullimi i Trafikut në qytet*
10. *Ndërtimi i të gjitha rrugëve sekondare në qytet*
11. *Ndriqimi Publik për të gjitha rrugët e qytetit*
12. *Regullimi i Trafikut në qytet*
13. *Ndertimi I qendrave per aktivitete rinore ne disa bashkesi lokale te qytetit*
14. *Ndërtimi i ndriqimit dekorativ në Urat e Qytetit, hamam dhe monumente historike*
15. *Rehabilitimi i Rrugëve në qytet*
16. *Ndërtimi i krojeve në qytet Xhamija e Sozit...*
17. *Ndërtim i rjetit të ujësjellsit Kojush-Mazrek*
18. *Ndërtimi i kanalizmit dhe rjetit të ujësjellsit në rr.I.Jashari-Ura te K.K.*
19. *Ndërtim të urës mbi kalim në lagjen Bazhdarhana*
20. *Sigurimi i Trotuarëve në të gjitha shkollat për fëmijë*
21. *Ndërtimi i kaptazhës për Ujë lagje Dardani*
22. *Ndërtimi i Urës së Arastës*
23. *Ndërtim i kaptazhës për Ujë lagje Tusuz*
24. *Ndertimi I rjetit te ujesjellesit ne rrugen Xhevat Berisha-Lagje e Trimave*
25. *Ndërtimi I shetitorës rreth kalasë*
26. *Ndërtimi I miniparqeve në Komunen e Prizrenit*
27. *Planifikimi I hapësirave te reja për planifikim urbanistik*
28. *Mbjellja e fidaneve drunore te reja ne qytet*
29. *Rehabilitimi I deponisë në Korishë*
30. *Vendosja e rrethojave standarte ne qytet*
31. *Rregullimi I parkut ne lagjen e Dardanisë*
32. *Instalimi I ndriqimit public ne lagjen e Dardanisë*
33. *Fshirja dhe larja e rrugëve ,shesheve dhe trotuareve*
34. *Ndërtimi I rrugës Prizren-Novosellë*
35. *Ndërtimi I rjetit te ujësjellesit ne fshatin Nepregoshte*
36. *Ndërtimi I rrugës Janina-tranzit*
37. *Procedurimi I largimit te ish-vetëshërbimit te Lirisë në bazhdarane*
38. *Ndërtimi I kanalizimit në fshatin Kushnin-has*
39. *Ndërtimi I infrastrukturës rrugore Tranziti-Lubizhdë*
40. *Shënjestimi horizontal dhe vertical në komunen e Prizrenit*
41. *Ndërtimi I shtallave ne kooperim me caritasin zviceran*
42. *Rehabilitimi I sistemit te ujit në toka bujqësore*
43. *Eliminimi I qëneve endacak në komunen e Prizrenit*
44. *Drenazhimi I tokave bujqësore*
45. *Renovimi I stallave dhe ngritja e serave*

46. *Trajnim dhe aftësim profesional te stafit të mësimdhënësve*
47. *Pajisja me pako standard te mjeteve mësimore*
48. *Pajisje e p[unëtorive ,kabineteve dhe laboratoreve*
49. *Instalimi dhe mirëmbajtja e internetit*
50. *Rregullimi I tëreneve sportive*
51. *Ndërtimi I shkollës fillore Gjonaj*
52. *Ndërtimi dhe zgjërimi I objekteve parashkollore*
53. *Ndërtimi I palestrës sportive Korishë*
54. *Ndërtimi I palestrës sportive Zhur*
55. *Ndërtimi I palestrës sportive Velezhë*
56. *Instalimi I nxemjesë qendrore në tetë fshatra te komunës*
57. *Ndërtimi I gardheve në gjashtë fshatra të komunës*
58. *Renovimi I fiziatrisë së QMF 1*
59. *Ndërtimi I ambulancës në Landovicë*
60. *Mirëmbajtja dhe renovime te QMF-ve*
61. *Ndërtimi I QKMF në ortakoll*
62. *Ndërtimi I furrës për djegjen e materialve medicinal*
63. *Ndërtimi I ambulantës në fshatin Petrovë*
64. *Ndërtimi I një nënstacioni te brigadës së zjarrfiksëve*
65. *Blerja e automjeteve për brigadën e zjarrfiksëve*
66. *Hartimi I planit general urbanistik*
67. *Planet rregullative*
68. *Hartimi I projekteve ne nivel te të gjitha sektoreve*
69. *Blerja e pajisjeve gjeodezike*
70. *Dixhitalizimi I kadastrit*
71. *Rregullimi I zyrave locale*
72. *Blerja e inventarit për administrat*
73. *Furnizimi I administratës me pajisje të reja*
74. *Sistemi I vezhgimit dixhital*
75. *Ndërtimi I kejit te Lumbardhit*
76. *Ndërtimi I miniparkut në brione*
- 77.

5 Buxheti komunale dhe menaxhimi financiar i komunës

Do të udhëhiqet mbi parimet e një politike fiskale të shëndoshë duke promovuar zhvillimin ekonomik dhe krijuar bazat për rritje afatgjate të të hyrave komunale.

Do të menaxhohen me shumë efikasitet të hyrat komunale të Komunës, siç është tatimi në pronë.

Për të zgjeruar bazën tatimore, do të ulet norma e tatimit në pronë dhe do të bëhet zonimi i të gjithë territorit të Komunës.

Do të sigurohet një menaxhim funksional dhe plotësisht transparent i planifikimit, implementimit dhe mbikëqyrjes së shpenzimeve komunale.

6 Cilësia dhe efikasiteti shërbimeve komunale

Komuna do të angazhohet fuqishëm në rritjen e efikasitetit të shërbimeve komunale ndaj qytetarëve duke rritur kështu cilësinë e jetës të të gjithë qytetarëve.

Do të ndërmerren masa radikale në ofrimin e shërbimeve cilësore në furnizimin me ujë, kompletimin e rrjetit të kanalizimit për të evituar ndotjen e ujërave nëntokësore, transporti në mes të qytetit dhe zonave rurale si dhe transporti ndërkomunal me komunat përreth etj.

Do të punohet në ofrimin e shërbimeve më të shpejta të ofiqarisë dhe të dokumenteve tjera komunale. Në këtë drejtim do të konsiderohet decentralizimi i këtyre shërbimeve dhe ofrimi i tyre tek qytetarët. Do të sigurohet orari rrëshqitës i punës së ofiqarisë në mënyrë që qytetarët të pajisen me dokumente në kohën që atyre ju përshtatet.

Do të rishikohet sistemi i transportit në kuadër të komunës për të siguruar cilësi në këto shërbime dhe efikasitet. Do të përcaktohen tarifat e transportit ndërkomunale që do të respektohen nga të gjithë ofruesit e shërbimeve transportuese.

Në zonat rurale do të investohet në instalimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik.

Do të sigurohet mirëmbajtja dimërore e të gjitha rrugëve në komunë që janë të rëndësishme për jetën dhe biznesin në kuadër të komunës.

Do të sigurohet komunikim efektiv me qytetarët për të garantuar që nevojat e tyre janë adresuar drejtë nga ana e organeve komunale.

7 Qeverisja komunale efektive, transparente dhe me përfshirje të qytetarëve

Qeverisja komunale do të bazohet plotësisht në transparencë në të gjitha aktivitetet komunale. Këshilli i drejtorëve do të përbëhet prej personave profesionist të fushave përkatëse për të siguruar punë efikase dhe shërbime të shpejta për qytetarë. Këta persona bashkë me një administratë komunale që do të trajnohet vazhdimisht do të sigurojnë zbatimin e këtij programi qeverisës.

Si Kryetarë i Komunës do të angazhohem vazhdimisht në vlerësimin e performancës së punës të të gjithë ekipit tim të drejtorëve dhe përmes tyre të shërbyesve civil në komunë në të gjitha nivelet.

Gjatë gjithë qeverisjes sime do të angazhohem për të siguruar një frymë bashkëpunimi në komunë në mes të stafit në të gjitha nivelet për të siguruar koordinim maksimal të drejtorive dhe shërbimeve të ndryshme, i cili koordinim është shumë i rëndësishëm për sigurimin e qeverisjes efikase dhe realizim të shumë projekteve të parapara në këtë program qeverisës.

Mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve dhe trupave tjera të Komunës do të jenë plotësisht të hapura për publikun.

Në qeverisjen time do të mbaj një dialog të afërt dhe të drejtpërdrejt me qytetarët në të gjitha lokalitetet e komunës përmes debateve me qytetarë, vizitave në lokalitete të ndryshme, institucione shkollore, kulturore, sportive e shëndetësore të komunës etj. Përmes këtij dialogu me qytetarët do të sigurohet realizimi i projekteve me prioritet sipas nevojave të lokaliteteve të ndryshme të komunës.

Në qeverisjen time do të sigurojë një ndarje të drejtë të resurseve të komunës.

8 Biografia e kandidatit për Kryetar të Komunës, z, Hanefi Muharremi

1. TË DHËNAT PERSONALE

Emri; Hanefi	Emri i mesëm; Shefqet	Mbiemri; Muharremi
Data e lindjes; 30.08.1953	Vendi i lindjes; fsh, Brut, Dragash	Shteti; Republika e Kosovës
Adresa – Kodi Postar; “Kasëmbeg”, nr. 17, Prizren 20000		
Telefoni; 029 / 243 643	Tel. mobil; 044 / 131 552	E-maili; hmuharremi@hotmail.com
Nacionaliteti; Shqiptar	Statusi martesor; I martuar/ 3 fëmijë, 2 vajza të martuara	Gjendja familjare; 3 anëtar; Bashkëshortja dhe vajza
		Shtetësia; Kosovar

2. EDUKIMI ARSIMOR

Emri i Kolegjit, Universitetit;	Data Prej Deri	Kualifikimi	Drejtimi
Universiti i Zagrebit;	1975 - 1978	Inxhinier i Komunikacionit Rrugor	Komunikacion
Shkolla Speciale Teknike - Beograd;	1996 - 1996	Sigurim në Komunikacion	Komunikacion

3. NJOHJA E GJUHËVE

(5 Shkëlqyeshëm, 4 Shumë Mirë, 3 Mirë, 2 Dobët)

	Shqip	Anglisht	Serbokroatisht	Turqisht		
E folur	5	4	5	4		
E shkruar	5	3	5	4		

4. SHKATHËSITË NË KOMPJUTER

Programet	Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë
OS. MË 5/98/ME/NT/2000/XP		x	
Microsoft Ëord	X		
Microsoft Excel	X		
Microsoft Office access		x	
Microsoft Outlook		x	
Internet explorer		x	
HTML, XHTML		x	
Të tjera të ngjajshme			x

5. PËRVOJA PROFESIONALE

Emri i Kompanisë/Ndërmarrjes: Organizata e Përbërë e Transportit Rrugor "Kosovatrans", pastaj "Prizren Prevoz"	Adresa: Prizren	"Zef Mark Lushi", p.n.
Punësuar; Prej (M./V.) Shkurt 1980 1991	Deri (M./V.) Nëntor	Tel: 029 / 31 151
Pozita: Udhëheqës i transportit ndërrurban dhe ndërkombëtar		
Përshkrimi i punës: <ul style="list-style-type: none"> • Organizimi dhe mbikqyrja e transportit ndërrurban, • Organizimi dhe mbikqyrja e transportit ndërkombëtar. • Anëtarë i Bordit Krahinor për harmonizimin e linjave ndërrurbane dhe ndërkombëtare 		

Emri i Kompanisë/Ndërmarrjes: Ndërmarrja Prodhuese Tregtare Shërbyese "Art – Commerc-Tours",	Adresa: Prizren	"M. Tito", 34.
Punësuar; Prej (M./V.) Shkurt 1992 1998	Deri (M./V.) Maj	Tel:
Pozita: Drejtor i Ndërmarrjes		

Përshkrimi i punës:

- **Agjencion Turistik.**

Emri i Kompanisë/Ndërmarrjes: Shkolla e Mesme Teknike "Gani Qavdarbasha"	Adresa: "Kaçaniku", p.n. Prizren
Punësuar; Prej (M./V.) Shtator 1999	Deri (M./V.) Dhjetor 2000 Tel:
Pozita: Profesor i lëndëve Profesionale	
Përshkrimi i punës: Ligjërimi në katër lëndë profesionale të lëmisë së komunikacionit për nxënësit e klasës së I-rë-III-të dhe IV-të.	

Emri i Kompanisë/Ndërmarrjes: Kuvendi Komunal - Prizren	Adresa: "Sheshi i Lidhjes", p.n. Prizren
Punësuar; Prej (M./V.) Janar 2001 2007	Deri (M./V.) Qershor Tel: 029 / 41 972
Pozita: Drejtor i Drejtorisë për Komunikacion dhe Lidhje	
Përshkrimi i punës: <ul style="list-style-type: none">▪ Hartimi dhe përpilimi i Rregulloreve e Udhëzimeve administrative për rregullimin e transportit dhe trafikut në komunën e Prizrenit.▪ Sigurimi i komunikacionit në tërë territorin e komunës së Prizrenit▪ Ndërtimi i infrastrukturës rrugore, menaxhimi dhe mirëmbajtja▪ Menaxhimi i hapësirave publike.▪ Mbarëvajtja e shërbimeve Telekomunikuese, Elektroenergjetike dhe Ndriçimi Publik▪ Planifikimi, ofrimi i shërbimeve profesionale dhe mbikqyrja e organizatave dhe shoqatave që mirren me aktivitete të lëmisë së komunikacionit dhe lidhjes▪ Menaxhimi në implementimin e projekteve kapitale që kapin shumën mesatare rreth 50 % të buxhetit komunal. Anëtar i Komisionit Profesional të MTPT-së për Revidimin e projektit të Auto-udhës „Morinë - Merdare“, Kosovë.	
Emri i Kompanisë Ndërmarrjes: "Hidroregjioni Jugor", SHA, Prizren me Njësitë; Prizren, Suharekë, Dragash dhe Malishevë	Adresa: "Vatrat Shqiptare", p.n. Prizren
Punësuar; Prej (M./V.) Korrik 2007	Deri (M./V.) aktualisht Tel: 029 / 244 107
Pozita: - Zëvendës Drejtor Regjional; deri me datën 16.05.2008 - Drejtor Regjional; nga data 17.05.2008 dhe aktualisht	
Përshkrimi i punës: <ul style="list-style-type: none">▪ Hartimi i Rregullores mbi sistematizimin e brendshëm.▪ Menaxhimi i funksionimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit▪ Menaxhimi i inkasimit të mjeteve▪ Menaxhimi i mirëmbajtjes të rrjetit▪ Mbikqyrja e cilësisë dhe kualitetit të ujit▪ Hulumtimi i masave për zvogëlimin e humbjeve▪ Hulumtimi i donacioneve për investime në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit	

Emri i Kompanisë: Aeroporti Ndërkombëtarë I Prishtinës	Adresa: Prishtinë
Punësuar; Prej (M./V.) Korrik /2008	Deri (M./V.) aktualisht Tel:
Pozita: Anëtar i Bordit Menaxhues të Aeroportit Ndërkombëtarë të Prishtinës	
Përshkrimi i punës: <ul style="list-style-type: none">▪ Menaxhimi i gjithëmbarshtëm i funksionimit të ANP-së▪ Zgjedhja e kuadrave udhëheqëse dhe vlerësimi i tyre▪ Nxitje për linijat e reja▪ Nxitje për linija të gjata dhe të shkurta▪ Nxitje për ritjen e trafikut në linijat egzistuese	

- Nxitje për operimin e CARGO-s
- Marketingun etj.

6. TË DHËNA TJERA;

- Përveç përshkrimit të lartëshënuar rreth përvojës sime profesionale, janë edhe shumë aktivitete tjera të paevidentuara në këtë rast ku konsideroj se nuk janë të parëndësishme për të patur pasqyrë dhe imazh të saktë rreth personalitetit tim prej intelektualit dhe nivelit profesional prej eksperti.
- 2004, Ankara, Turqi, vizitë zyrtare Kryetarit të Ankarasë (Melik Gykqë) dhe stafit të tij me qëllim të shkëmbimit të përvojave në menagjimin e transportit public dhe ndërtimit të infrastukturës.

Deklaratë;

ME KËTË DEKLARATË, UNË VËRTETOJ ME PËRGJEGJËSI TË PLOTË SE TË GJITHA INFORMATAT E LARTËSHËNUARA JANË TË VËRTETA DHE TË PLOTA. UNË AUTORIZOJ MINISTRINË E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE INSTITUCIONET PËRKATËSE TË VERIFIKOJNË INFORMATAT E DHËNA NË KËTË “CV”.

9 LISTA E KANDIDATË VE TË LDK-SË PËR ASAMBLE KOMUNALE

